



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
MINISTRI

Nr. 3893 prot.

Datë 07.10 2022

UDHËZIM

Nr. 571, Datë 07.10 2022

**PËR PROCEDURAT E REKRUTIMIT TË  
PUNONJËSVE PSIKOLOGË/PUNONJËS SOCIAL NË STRUKTURAT PUBLIKE  
SHËNDETËSORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 dhe të nenit 199 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.508 datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, Urdhër nr. 413, datë 13.07.2022 “Për miratimin e Statutit të Qendrës Shëndetësore”

**UDHËZOJ:**

**KREU 1  
TË PËRGJITHSHME**

1. Ky udhëzim rregullon procedurat për punësimin e punonjësve psikolog/punonjës social në strukturat e shërbimit parësor dhe spitalor në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Procedurat për punësimin e psikolog/punonjës social udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, barazisë dhe interesit më të lartë të shëndetit publik.
3. Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet ndërfaqes “Psikologë/punonjës social” në Portalin “Mjekë për Shqipërinë”.
4. Drejtoria Qendrore e Operatori të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vazhdim DQOSHKSH) është institucioni përgjegjës për publikimin e thirrjes për Psikologë/punonjës social në një vend të lirë pune në institucionet shëndetësore publike, ndërsa Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vazhdim DROSHKSH) dhe Drejtoritë e Spitaleve Universitare (në vazhdim DSU) respektivisht, organizojnë procedurat sipas këtij udhëzimi.
5. DROSHKSH dhe DSU kanë detyrimin të raportojnë në DQOSHKSH vendet vakante Psikologë/punonjës social për të cilat do të shpalllet konkurimi.
6. DQOSHKSH ka detyrimin të shpallë në ndërfaqen “Psikologë/ punonjës social” në portalin “Mjekë për Shqipërinë”, vendet e lira të punës për çdo institucion shëndetësor publik të grupuara për çdo DROSHKSH. Për Spitalet Universitare shpallja bëhet për secilin spital në veçanti.

7. Kandidatët e interesuar për t'u punësuar si Psikologë/ punonjës social në institucionet shëndetësore publike marrin pjesë në konkurrim, i cili zhvillohet në dy faza:
  - a) Konkurrimi me dosje;
  - b) Intervista me gojë

## **KREU II**

### **SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS DHE APLIKIMI**

1. Drejtoria Qendrore e OSHKSH mbledh të dhënat për vendet vakante nga institucionet shëndetësore publike në varësi të OSHKSH-së si dhe Qendrat Spitalore Universitare dhe i publikon ato në portal.
2. Shpallja në ndërfaqen "Psikologë/ punonjës social" përmban këto të dhëna:
  - a) kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë kandidati për pranim;
  - b) fushën kryesore mbi të cilën do të bazohet intervisa;
  - c) dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;
  - d) afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
  - e) datën e njoftimit të verifikimit paraprak të kandidatëve;
  - f) mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në fazën e verifikimit paraprak, si dhe intervistën;
  - g) mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.
3. Kandidatët e interesuar, regjistrohen në ndërfaqen "Psikologë/ punonjës social" në portalin "Mjek për Shqipërinë" dhe ngarkojnë në portal dokumentat e kërkuar.  
Një kopje e dokumentave dërgohet pranë DROSHKSH apo Spitaleve Universitare me postë ose dorazi me protokoll.
4. Dosja e aplikimit përmban:
  - a) Jetëshkrimin e kandidatit (CV), (i detyrueshëm);
  - b) Fotokopje e kartës së identitetit; (e detyrueshme)
  - c) Diplomën universitare dhe listën e notave. Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit; diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (e detyrueshme);
  - d) Librezën e punës;
  - e) Diplomën e nivelit master;
  - f) Lejen e ushtrimit të profesionit;
  - g) Dëshmi të kualifikimeve shkencore (gradë ose titull akademik/shkencor);
  - h) Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja;
  - i) Çertifikatat e pjesëmarrjes në aktivitetet e edukimit në vazhdim të ndjekura brenda dhe jashtë vendit;

## **KREU III**

### **VLERËSIMI DHE EMËRIMI**

1. Kandidatët do të vlerësohen për diplomën, gjuhën e huaj, përvojën në profesion, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën si dhe për intervistën me gojë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 50 pikë, përkatësisht:
  - a) deri në 30 pikë vlerësimi i dosjes;
  - b) deri në 20 pikë vlerësimi i intervistës me gojë.Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve, përcaktohet në shtojcën 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Komisioni i Vlerësimit, brenda tre ditë pune pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe i njofton ata nëpërmjet adresës së email, për pikët që ka marrë nga vlerësimi i dosjes si dhe për datën dhe vendin e intervistës. Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit njofton me email dhe kandidatët që nuk janë kualifikuar për arsyet e moskualifikimit.
3. Kandidatët kanë të drejtë ankimi brenda dy ditëve nga njoftimi i tyre. Ankesa bëhet nëpërmjet adresës së email të DROSHKSH ose Spitaleve Universitare.
4. Komisioni i Vlerësimit ditën e intervistës përgatit pyetjet të cilat duhet të jenë të njëjta për të gjithë kandidatët. Në përfundim hartohet lista me pikët totale për çdo kandidat dhe brenda dy ditëve i njofton ata për rezultatin, nëpërmjet adresës së tyre me email.
5. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit për rezultatin përfundimtar, brenda dy ditëve nga data e njoftimit të tyre. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankimesit me shkrim ose sipas formës që do të dakortësohet.
6. Pas përfundimit të afateve të ankimit dhe shqyrtimit të ankesave, Komisioni i Vlerësimit shpall renditjen e kandidatëve dhe e dërgon pranë DQOSHKSH, e cila mënjëherë bën publikimin në portal.
7. Kandidati i cili në renditjen e përgjithshme sipas NJVKSH-së/Spitalit, është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendet e lira të punës në Njësinë/Spitalin ku ka aplikuar.
8. Kandidati fitues që përzgjedh vendin e punës sipas pikës 7), merr aktin e emërimit nga DROSHKSH dhe paraqitet pranë institucionit shëndetësor për të lidhur kontratën e punës. Titullari i institucionit lidh kontratë pune pa afat me psikologun/ punonjësin social që zë një vend të lirë pune. Periudha e provës është tre muaj.

#### KREU IV KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë:
  - a) DQOSHKSH krijon Komisionet për Vlerësimin e kandidatëve për psikologun/ punonjësin social në spitalet Rajonale e Bashkiake/ NJVKSH dhe në Qendrat Shëndetësore, me përbërjen si më poshtë:
 

1) Drejtori i DROSHKSH	Kryetar
2) Një përfaqësues nga DQOSHKSH	Anëtar
3) Një përfaqësues nga shërbimi spitalor ose NJVKSH	Anëtar
  - b) Spitalet Universitare krijojnë një komision të brendshëm për vlerësimin e kandidatëve.
2. Komisioni kryen detyrat si më poshtë:
  - a) administron dosjet e aplikantëve që kanë aplikuar në portal;
  - b) vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati, sipas kritereve të vlerësimit të
  - c) përcaktuara në këtë udhëzim;
  - d) bën intervistimin e kandidatëve;
  - e) bën njoftimin e kandidatëve për pikët e vlerësimit;
  - f) shqyrton ankesat e kandidatëve;
  - g) bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra në secilën fazë të vlerësimit dhe ato
  - h) në total në përfundim të vlerësimit;
  - i) dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DQOSHKSH dhe në MSHMS listën me pikët për çdo kandidat.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR**

**Ogerta Manastirliu**



**SHTOJCA 1****KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR  
PSIKOLOGE/ PUNONJES SOCIAL**

<b>Nr.</b>	<b>Treguesit dhe kriteret</b>	<b>Pikët</b>
1.	Përvojë pune në profesion (një pikë për çdo vit pune, deri në 10 vite eksperiencë pune)	0 -10 pikë
2.	Nota mesatare e studimeve të larta. Vlerësimi sipas kësaj skeme: Nota mesatare e (thjështë) 5.00 - 6.00 = 2 pikë Nota mesatare e (thjështë) 6.01 - 7.00 = 4 pikë Nota mesatare e (thjështë) 7.01 - 8.00 = 6 pikë Nota mesatare e (thjështë) 8.01 - 9.00 = 8 pikë Nota mesatare e (thjështë) 9.01 - 10.00 = 10 pikë	1- 10 pikë
3.	Gjuhë e huaj e mbrojtur (sipas njohjes nga Ministria e Arsimit dhe Sportit) - 2 pikë	0-2 pikë
4.	Leja e ushtrimit të profesionit	0-2 pikë
5.	Diplomë shtesë (mbi kerkesat e vendit të Punës) Master profesional - 2 pikë Master shkencor - 4 pikë	0-4 pikë
6.	Trajnime dhe kualifikime që lidhen me fushën – maksimumi 2 pikë Trajnime dhe kualifikime me kohëzgjatje dy javë deri në 1 muaj – 1 pikë Trajnime dhe kualifikime me kohëzgjatje më shumë se një muaj – 2 pikë	0-2 pikë